



## **VENDIMI MBI PRANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 11 dhjetor 2019**

**Nr. i lëndës: 2016-17**

**Milijana Avramović**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 11 shtator 2019, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaël METTRAUX, kryesues  
Z. Petko PETKOV, anëtar zëvendësues  
Znj. Anna AUTIO, anëtare

Ndihmuar nga:  
Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është corëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 15 janar 2019,

Pas takimit, është vendosur si në vijim:

### **I. PROCEDURA**

1. Ankesa në këtë lëndë është regjistruar në Panel më 30 qershor 2016.
2. Përmes letrës së datës 1 korrik 2016, Paneli ka informuar Misionin se kjo lëndë ishte e regjistruar.
3. Më 28 qershor 2017, Paneli i ka kërkuar ankueses që të sigurojë informata shtesë në lidhje me ankesat e saj.
4. Më 20 shtator dhe 17 tetor 2017, Paneli ka dërguar dy kërkesa të tjera për informacion shtesë. Paneli nuk mori asnjë përgjigje në lidhje me këtë lëndë.

5. Më 8 dhjetor 2017, Paneli i ka përcjellë deklaratën e fakteve dhe pyetjeve shifes së Misionit (ShM-së), EULEX-i Kosovë, duke e ftuar atë të paraqiste përgjigjet dhe vërejtjet e saja me shkrim për ankesat deri me datën 26 janar 2018.
6. Përmes letrës së datës 17 janar 2019, nga Misioni ishte kërkuar që përsëri të ofronte përgjigje për pyetjet deri më 16 shkurt 2019.
7. Përmes letrës së datës 8 prill 2019, Paneli përsëri i kërkoj ShM-së që të sigurojë përgjigje për pyetjet sa më shpejt që është e mundur.
8. Me datën 20 qershor 2019, ankuesja ishte informuar që Paneli ishte ende në proces të shqyrtimit të ankesës së saj.
9. Vërejtjet e ShM-së përfundimisht ishin marrë me datën 30 korrik 2019, pas së cilës ato iu komunikuan ankuesve për vërejtje shtesë.
10. Më 5 gusht 2019, komentet e ushtruesit të detyrës së ShM-së iu dërguan ankueses, dhe asaj iu kërkuar të paraqiste komentet e saja, nëse kishte ndonjë, jo më vonë se me datën 6 shtator 2019.
11. Ankuesi nuk e ka shfrytëzuar mundësinë për t'iu përgjigjur parashtrimeve të Misionit.

## II. FAKTET

12. Faktet e çështjes, siç paraqiten nga ankesa, mund të përmbliidhen si më poshtë.
13. Më 19 qershor 1999, rreth orës 07.30, bashkëshort i ankueses, Milorad Avramović, ishte rrëmbyer me katër burra të tjerë dhe një grua në rrugën Shën Starca Vujadina 3/1, Tamnik, në Mitrovicë. Në kohën e rrëmbimit të tij, ai ishte duke e ndihmuar me kamion gruan e lartpërmendur për të ndërruar shtëpinë nga jugu i Mitrovicës në veri të Mitrovicës.
14. Personat e rrëmbyer ishin dërguar në një shtëpi tjetër afër në Tamnik, Mitrovicë, ku u morën në pyetje për disa orë. Tre nga burrat dhe gruaja u lanë të lirë nën kujdesin e ushtarëve të KFOR-it. Ushtarët e KFOR-it kontaktuan me policinë e UNMIK-ut, të cilët i dërguan në veri të Mitrovicës. Milorad Avramović-i dhe vozitësi i kamionit u mbajtën gjatë natës. Drejtuesi i automjetit u la i lirë mëngjesin tjetër. Që atëherë nuk ka asnjë gjurmë nga Milorad Avramović-it.
15. Ankuesi ka raportuar zhdukjen në UNMIK, KFOR, KNKK dhe organizatat joqeveritare vendore në Mitrovicë.
16. Më 14 qershor 2000, motra e Milorad Avramović-it dha një deklaratë të dëshmitarit për zhdukjen e vëllait të saj tek një gjykatës hetues në gjykatën e qarkut në Leskovc, Republika e Serbisë. Kjo deklaratë dhe informacione të tjera me rëndësi janë të përfshira në dosjen e ëndës.

## III. ANKESA DHE QËNDRIMI I ANKUESIT

17. Ankuesja shprehimisht nuk i referohet ndonjë dispozite ligjore që ajo pretendon se është shkukur nga Misioni. Sidoqoftë, nga përmbajtja e ankesës do të duket se ankesa ka të bëjë me të drejtat e mbrojtura nga neni 2 (e drejta e jetës) dhe 3 (ndalimi i torturës dhe trajtimit mizor) dhe ndoshta neni 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)

dhe 13 (e drejta për mjete efektive juridike) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa).

18. Duke e pasur parasysh lidhjen e ngushtë familjare ndërmjet viktimës së drejtpërdrejtë – Milorad Avramović – dhe ankuesit – Milijana Avramović – Paneli është i bindur që ankuesi mund të konsiderohet si viktimë dytësore e shkeljeve të supozuara dhe, si e tillë, viktimë e mundshme në përputhje me Rregullën 25(1) të Rregullores së Punës së Panelit. Paneli vëren gjithashtu, se qëndrimi i ankuesit nuk po kundërshtohet nga Misioni.

#### **IV. LIGJI**

19. Bazuar në përmbajtjen e ankesës, Paneli kupton që ankuesja pretendon se EULEX-i ka shkelur të drejtat e saja sipas neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës.
20. Të njëjtat të drejta themelore të njeriut janë të garantuara nga një numër i instrumenteve të tjerë ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut, përfshirë Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe si çështje e ligjit zakonor ndërkombëtar.

#### **V. PARASHTRESAT NGA PALËT**

##### **Ankuesja**

21. Siç përmbledhet më lartë, ankuesja pretendon se EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv duhej të kishte hetuar zhdukjen e bashkëshortit të saj dhe me faj nuk e ka bërë atë në kundërshtim me të drejtat themelore të tij dhe të bashkëshortit të saj.

##### **Shefi i Misionit ("ShM")**

22. Përmes letrës së datës 30 korrik 2019, ShM-ja iu përgjigj pyetjeve të Panelit në lidhje me këtë lëndë.
23. Në pyetjen nëse Misioni kishte qenë në dijeni të ekzistencës së këtij rasti, Misioni ka thënë se si pjesë e transferimit të lëndëve nga UNMIK-u në Mision, Misioni mori disa dokumente në lidhje me zhdukjen e z. Avramović. Njësia e Hetimit për Krimet e Luftës të EULEX-it (NjHKL) pranoi dokumente nga një dosje, e hapur nga Njësia e Personave të Zhdukur të UNMIK-ut, si dhe dokumente nga një dosje e hapur nga Njësia e UNMIK-ut për Krimet e Luftës. Stafi i Misionit në Institutin e Mjekësisë Ligjore (IFM/DFM) gjithashtu pranoi një numër dokumentesh përfshirë disa me origjinë nga KFOR-i francez dhe Stacioni i Policisë së UNMIK-ut në Mitrovicë. Në kohën e dorëzimit të dosjeve të lëndës nga UNMIK-u në EULEX, NjHKL-ja e EULEX-it pranoi një dosje të lëndës 'krim lufte' që lidhej me z. Avramović (që përmbante dokumente të trajtuara nga Njësia e Krimeve të Luftës së UNMIK-ut) dhe posaqërisht një dosje të 'personit të zhdukur' në lidhje me të.
24. Misioni ka treguar që sipas të dhënave të veta ankuesja asnjëherë nuk e ka sjellur zhdukjen e burrit të saj në vëmendjen e Misionit.
25. Në lidhje me pyetjen se çfarë masash, nëse ka pasur ndonjë, i kishte marrur për të regjistruar, ruajtur dhe kategorizuar rastet e tilla, Misioni dha një shpjegim të gjerë të

procesit të dorëzimit të lëndëve nga UNMIK-u dhe procesin e shqyrtimit dhe kategorizimit të lëndëve në nivelin e Misionit.

26. Në tërësi, dosjet e 'krimeve të luftës' dhe 'personave të zhdukur' të dorëzuara nga Policia e UNMIK-ut në NjHKL-në e EULEX-it përfshinin afro 800,000 faqe. Përveç këtyre dosjeve, UNMIK-u gjithashtu dorëzoi disa baza të të dhënave, duke përfshirë një për dosjet e policisë të "krimeve të luftës" dhe një për "personat e zhdukur".
27. Në rastin e z. Avramović, dosja e lëndës ishte në të vërtetë e përbërë nga një dosje për 'krime lufte' dhe një dosje të një 'personit të zhdukur', përveç të cilave kishte dokumente me origjinë nga burime të tjera (UNMIK) (shih, më lart, paragrafi 23). Lënda e z. Avramović u klasifikua nga UNMIK-u "e hapur" ose "në pritje" për shkak të faktit se as ai dhe eshtrat e tij nuk ishin gjetur.
28. Dosja e lëndës së krimeve të luftës në lidhje me z. Avramović u dërgua për rishqyrtim dhe vlerësim në ZPSK të EULEX-it më 20 mars 2009.
29. Misioni shtoi se përmbajtja e dosjeve të krimeve të luftës së policisë dhe dosjet e personave të zhdukur nuk ishin krahasuar apo bashkuar nga Misioni me dorëzimin e atyre dosjeve. Përparësi duket se iu ishte dhënë "dosjeve të krimeve të luftës", bazuar në faktin se një kontroll i plotë i të gjitha dosjeve do të kishte bërë të nevojshme mbajtjen pezull, të paktën pjesërisht, të punës rreth hetimeve të hapura të trashëguara nga UNMIK-u".
30. Kategorizimi i lëndëve ishte një "sfidë e madhe" për EULEX-in për shkak të peshës së çështjes dhe papërshtatshmërisë së disa prej klasifikimeve të UNMIK-ut. Në kohën e dorëzimit të lëndëve, dosja e lëndës së z. Avramović ishte ajo e një "personit të zhdukur". Për të adresuar këtë sfidë, EULEX-i duhej të bënte disa rishikime të dosjeve të UNMIK-ut. Ky proces i rëndë u komplikua edhe më tej nga çështjet që kishin të bënin me personelin dhe rikonfigurimin e Misionit, i cili rezultoi që në disa dosje të lëndëve kishin humbur dokumente, raporte ose fotografi.
31. Pas rishikimit nga ana e Misionit, dosja e lëndës për krime lufte që i përkisnin z. Avramović u kategorizua nga ZPSK si rast i krimit të luftës/rrëmbimit dhe mori një numër në ZPSK.
32. Pas shqyrtimit të dosjes së lëndës, më 23 korrik 2009, prokurori i ZPSK-së kërkoi nga NjHKL që të zhvillojë një hetim për atë çështje. Sidoqoftë, NjHKL nuk e përcolli këtë kërkesë specifike.
33. Në vitin 2010 dhe 2013, janë bërë rishikime të mëtejshme të dokumenteve në posedim të EULEX-it. Misioni nuk tregoi nëse dhe si ndikoi kjo në rastin e z. Avramović.
34. Në prill 2018, dosja e lëndës në lidhje me z. Avramović iu dorëzua institucioneve kompetente të Kosovës. Shënimi i dorëzimit të dosjes drejtuar kryeprokurorit (asokohe) të SPRK-së përmbante një ftesë për t'u ndërlidhur me NjHKL-në e EULEX-it në lidhje me veprimet e ndërmarra rreth kërkesës për të kryer një hetim të muajit korrik 2009.
35. Në parashtrësat e tij, Misioni tregoi se nuk ishte në dijeni rreth hetimeve të vazhdueshme të kësaj lënde nga autoritetet e Kosovës.
36. Në pyetjen nëse të afërmit e z. Avramović ishin të përfshirë në hetimin e këtij rasti dhe nëse ata ishin intervistuar nga Misioni, ShM-ja ka thënë se ankuesi ka dhënë deklarata e dhënë në KFOR në qershor 1999 dhe në stacionin e Policisë së UNMIK-ut në Mitrovicë në dhjetor 1999. Dhe në qershor 2004, ankuesi dhe babai i të zhdukurve u intervistuan

nga Njësia e Personave të Zhdukur të UNMIK-ut. Misioni nuk kishte asnjë kontakt me ankuesin ose të afërmit e z. Avramović. Dokumentet nga dosjet e lëndës ose përmbajtja e tyre nuk duket se u janë komunikuar familjes së z. Avramović.

37. Në pyetjen nëse dëshmitarët apo të dyshuarit e mundshëm janë marrë në pyetje, Misioni duket se sugjeron që EULEX-i nuk ka bërë ndonjë marrje në pyetje apo intervistim të tillë.
38. Më në fund, në lidhje me pranueshmërinë e lëndës, Misioni tregon se "nuk sheh arsye të qarta për të kundërshtuar pranueshmërinë e ankesës në çfarëdo baze". Sidoqoftë, Misioni fton Panelin që 'të konsideroj me kujdes' nëse ankuesi mund të konsiderohet se ka vepruar në pajtim me rregullin gjashtë mujor. Për më tepër, Misioni sugjeron që ankuesja nuk bën pretendime specifike kundër EULEX-it dhe as nuk përmend EULEX-in në ankesën e saj. Prandaj, Misioni i kërkon Panelit të vlerësojë nëse lënda 2016-17 mund të konsiderohet tash ankesë kundër Misionit dhe nëse jo ndryshe lënda të trajtohet si një kërkesë e thjeshtë dhe legjitime për informacion rreth statusit të hetimit.

### **Përgjigja e ankuesit**

39. Ankuesi nuk e shfrytëzoi mundësinë për t'u përgjigjur në parashtresat e misionit.

## **VI. VLERËSIMI I PANELIT NË LIDHJE ME PRANUESHMËRINË**

### *Çështja paraprake*

40. Si çështje paraprake, Paneli vëren se Misioni nuk e kundërshton zyrtarisht pranueshmërinë e këtij rasti, por fton Panelin të shqyrtojë çështjen e pajtueshmërisë së ankuesit me afatin 6-mujor, sipas Rregullës 25, paragrafi 3, të Panelit, rregullorja e punës së Panelit dhe natyra e parashtresave të saj si ankesë kundër EULEX-it (shih, *supra*, paragrafi 38).

### *Mandati i Panelit (Rregulla 25 paragrafi 1 i Rregullores së Punës)*

41. Si një çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar të zbatojë instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohet në Konceptin e Përgjegjshmërisë së EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet juridike demokratike.
42. Para shqyrtimit të ankesës mbi meritat e saj, Paneli duhet të vendosë nëse duhet të vazhdojë me ankesat, duke i marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në Rregullën 29 të Rregullores së Punës.
43. Sipas Rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë kryerjes së mandatit ekzekutiv të tij.
44. Paneli tashmë ka vërtetuar se veprimet e prokurorëve të EULEX-it dhe policisë janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe për këtë arsye bien në kuadër të mandatit të Panelit, (shiko, për shembull, *K deri T kundër EULEX-it*, 2013-05 deri 2013-

14, 21 Prill 2015, paragrafi 43; *Krlić kundër EULEX-it*, 2012-21, 26 gusht 2014, paragrafi 23; *Y kundër EULEX-it*, 2011-28, 15 nëntor 2012, par. 35).

45. Misioni nuk kundërshton se ishte kompetent për një periudhë kohore për të hetuar këtë rast dhe se ndërmori hapa të caktuar që kishin të bëjnë me këtë çështje dhe se dosja e lëndës iu dorëzua përfundimisht nga Misioni autoritetëve vendore në prill të vitit 2018. Kjo është periudha që ngrit shqetësim dhe ka të bëjë me lëndën në fjalë.
46. Implikimet e ndryshimeve në mandatin e Misionit në qershor të vitit 2018 për qëllimin e këtij rasti do të adresohen, nëse është e nevojshme, në vendimin e Panelit mbi meritat. Palët janë të ftuara të trajtojnë atë çështje nëse dëshirojnë të bëjnë parashtresa të mëtejshme në lidhje me meritat e kësaj çështjeje.

*Nëse ankesa i plotëson kërkesat përkatëse të formës dhe substancës ose nëse ajo përbën një kërkesë për informacion në lidhje me statusin e hetimit*

47. Në parashtresat e tij, ndërsa nuk e kundërshton drejtërdrejt pranueshmërinë e kësaj lënda, Misioni sugjeron që ankuesja nuk bën ndonjë pretendim specifik ndaj EULEX-it dhe madje nuk e përmend EULEX-in në ankesën e saj. Prandaj, Misioni i kërkon Panelit të vlerësojë nëse lënda 2016-17 mund të konsiderohet tash ankesë kundër Misionit dhe nëse jo ndryshe lënda të trajtohet si një kërkesë e thjeshtë dhe legjitime për informacion rreth statusit të hetimit.
48. Kërkesat e formës dhe substancës që rregullojnë përmbajtjen e një ankese para Panelit janë përshkruar në Rregulloren e Punës së Panelit (shih Rregullën 25 dhe më poshtë). Vlerësuar ndaj këtyre rregullave, Misioni nuk sugjeron që ankesa përmban ndonjë të metë zyrtare që mund të ndikonte në pranueshmërinë e kësaj lënde.
49. Në lidhje me çështjen e natyrës së ankesës dhe nëse ka të bëjë me veprimet që i atribuohen Misionit, Paneli do të theksojë si në vijim. Së pari, në përputhje me Rregulloren e punës së tij (dhe OPLAN), Paneli është kompetent për të vlerësuar vetëm ankesat për shkelje të të drejtave kundër Misionit. Rregulla 25, paragrafi 1, i Rregullores së Punës së Panelit parashikon kështu që '[një ankesë mund të paraqitet nga çdo person tjetër, përveç personelit të EULEX-it Kosovë, i cili pretendon se është viktimë e një shkelje të të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë veprimeve gjatë mandatit të tij ekzekutiv'. Në këtë kuptim, paraqitja e një ankese në Panel duhet patjetër dhe mund të lidhet vetëm me ndonjë pretendim të shkeljes së të drejtave që thuhet se i atribuohet Misionit.
50. Së dyti, në lidhje me përmbajtjen e ankesës, siç duket nga forma e ankesës të përdorur nga ky dhe ankuesit e tjerë, të gjitha ankesat në Panel përmbajnë një pretendim për shkelje të të drejtave (shih formularin e ankesës, psh. B) që i atribuohet, sipas formularit të ankesës, EULEX-it (shih formularin e ankesës, pika V). Prandaj, kjo ankesë është si duhet një ankesë për shkeljet e të drejtave kundër Misionit.
51. Sidoqoftë, Misioni është i saktë se një pjesë e mjetit juridik kërkuar nga ankuesi duket se i përket informacionit në lidhje me gjendjen e hetimit të kësaj çështjeje. Kjo do të jetë një çështje për t'u adresuar nga Paneli në fazën e mer tës së këtyre procedurave.

*Përputhshmëria me rregullën 6 mujore*

52. Në parashtresat e tij, Misioni fton Panelin që 'të shqyrtojë me kujdes' nëse ankuesi mund të konsiderohet se ka vepruar në pajtim me rregullin gjashtë mujor.

53. Në bazë të rregullës 25, paragrafi 3, të Rregullores së Punës së Panelit, një ankues duhet të paraqesë një ankesë brenda gjashtë muajve nga akti, vendimi ose veprimi për të cilën thuhet se përbën ose përfshin shkelje të të drejtave të tij/saj (shih p.sh. *Gashi kundër EULEX-it*, 2013-22, 7 prill 2014, par. 10; *Thaqi kundër EULEX-it*, cituar më lart, paragrafi 51).
54. Ankesa në atë rast u paraqit në Panel më 30 qershor 2016.
55. Në atë kohë, shkelja e pretenduar e të drejtave të ankuesit ishte ende në vazhdim e sipër, pasi rrethanat e zhdukjes së të afërmit të tij nuk ishin vërtetuar dhe askush nuk ishte sjellë para drejtësisë. Paneli vëren në lidhje me këtë se lloji i shkeljeve për të cilat bëhet ankesa konsiderohen si shkelje në vazhdim e sipër ose e vazhdueshme e të drejtave. Shih D.W., E.V., F.U., G.T., *Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi për pranueshmërinë, 30 shtator 2015, para. 78; Sadiku-Syla kundër EULEX, 2014-34, Vendim për pranueshmërinë, 29 shtator 2015, paragrafët 35 dhe 42. Shih gjithashtu, në kontekstin e nenit 3, GjJEDNj-së, Kurt kundër Turqisë, aktgjykimi i 25 maj 1998, Raportet e vendimeve dhe vendimeve 1998 III, paragrafët. 130-134; Khadzhaliev dhe të tjerët kundër Rosisë, Aplikacioni nr. 3013/04, aktgjykim i 6 nëntorit 2008, parag. 120-121; Timurtas kundër Turqisë, Aplikacioni nr. 23531/94, Aktgjykimi i datës 13 qershor 2000, par. 95; shih gjithashtu Rezolutën nr. 828 të vitit 1984, paragrafi 3 (Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës); lënda e *the Rio Negro Massacres kundër Guatemalës* (Aktgjykimi i datës 04.09.2012, kundërshtimi, meritat, riparimi dhe kostot paraprake), par. 112 lënda e *Gudiel Alvarez dhe të tjerët ("Diario Militar") kundër Guatemalës* (Aktgjykimi i datës 20.11.2012; meritat, riparimet dhe kostot), par. 191.
56. Deri në atë masë, ankesa ishte paraqitur brenda 6 muajve të kërkuar me rregulloren 25 (3) të rregullores së punës së Panelit, që fillon "nga data e shkeljes së pretenduar".
57. Për më tepër, Paneli thekson se lënda dhe dosja që lidhen me të ka mbetur në Mision deri në prill të vitit 2018 kur më pas iu ishte dorëzuar autoriteteve vendore. Deri në atë kohë, Misioni nuk dha asnjë tregues për ankuesin ose ndonjë të afërm tjetër të z. Avramović se do ta mbyllte ose do ta kishte mbyllur këtë çështje. Në vend të kësaj, nga parashtrirat e Misionit, duket se një kërkesë e PSRK-së për hetim ka mbetur e pazgjidhur deri në atë kohë.
58. Në këto rrethana, Paneli është i bindur që ankuesja ka parashtruar ankesën e saj brenda afatit 6 mujor të Panelit të caktuar me rregullore.
59. Paneli thekson që, *ratione temporis*, është kompetent që t'i shqyrtojë veprimet e këtij Misioni deri më 14 qershor 2018. Pas kësaj date, Misioni nuk kishte ndonjë përgjegjësi ekzekutive në lidhje me këtë rast. Megjithatë veprimet e kryera pas kësaj date mund të jenë relevante për ta vlerësuar shkallën në të cilën mund të thuhet se ky Mision i ka përmbushur detyrimet e veta ndaj të drejtave të njeriut pasi që ky obligim ende vlen mbi Misionin edhe pas përfundimit të mandati ekzekutiv. Prandaj Paneli fton Misionin që të ofrojë referenca në parashtrimet e veta për çfarëdo përpjekje të ndërmarrë nga ky Mision për të siguruar që ky rast ishte apo është duke u hetuar (nëse po), përfshirë pas kësaj date.

#### *Kompetenca ratione materiae e Panelit*

60. Misioni nuk e konteston kompetencën *ratione materiae* të Panelit lidhur me këtë rast dhe Paneli në fakt është i bindur që është kompetent lidhur me këtë çështje. Ky rast në mënyrë të qartë bën pjesë në kuadër të kompetencave ekzekutive (hetimore) të

organeve të këtij Misioni, të cilat në fakt i kanë shqyrtuar dosjet e lëndës së këtij rasti dhe kanë rekomanduar hetimin e mëtejshëm.

61. Konsistent me lëndët e mëparshme që kanë të bëjnë me çështje të ngjashme, Paneli është i bindur se është kompetent *ratione materiae* për t'u marrë me këtë lëndë.

## **PËR KËTO ARSYE, PANELI NJEZËRI**

**SHPLL TË PRANUESHME**, pa paragjykuar meritat e çështjes, ankesat lidhur me shkeljet e pretenduara të neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

## **KËRKON NGA PALËT QË T'I ADRESOJNË PYETJET NË VIJIM**

1. **Për ankuesin:** Ju lutemi ofroni informacione që kanë të bëjnë me pyetjet në vijim:

- i. Çfarë kontakti, nëse ka pasur, keni pasur ju me Misionin e EULEX-it apo me përfaqësuesit e tij?
- ii. A jeni në dijeni për ndonjë përpjekje nga autoritetet vendore për ta hetuar këtë rast?
- iii. A ka bërë shkelje apo a ka kontribuar Misioni në shkeljen e të drejtave të ankuesit sipas neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës? Nëse po, në çfarë mënyre?
- iv. Cilat janë pasojat personale, financiare, ligjore dhe emocionale që lidhen me zhdukjen e të afërmit tuaj?

2. **Për Misionin:** Ju lutemi ofroni informacione që kanë të bëjnë me pyetjet në vijim:

- i. Pse NjHKL-ja nuk e përcolli kërkesën e prokurorit të NjSRK-së (shih, supra, par. 32)? Në dijeninë tuaj, a kishte komunikim të mëtijshëm midis tyre lidhur me këtë çështje?
- ii. Pse Misioni nuk u përpoq të kontaktojë të afërmit e z. Avramović?
- iii. A e ka konsideruar Misioni që t'i informonte rreth ekzistencës së këtyre dosjeve të afërmit e atyre që janë zhdukur, dosjet e të cilëve u janë bartur autoriteteve vendore të Kosovës?
- iv. A është marrë parasysh mundësia që të afërmit e të zhdukurve të kenë qasje në to, dhe nëse po, kushtet në të cilat kjo mund të ndodhë dhe përmes cilave autoritete?
- v. Parashtresat e Misionit të datës 30 korrik 2019 tregojnë se shënimi për dorëzimin e dokumenteve i adresuar ish kryeprokurorit të ZSRK-së përmbante një ftesë që të bëhej ndërlidhja me NjHKL-në e EULEX-it në lidhje me veprimet e ndërmarra rreth kërkesës për të kryer një hetim të korrik të vitit 2009. Cilave 'veprime' i referohet ky shënim? A ka kryer Misioni veprime hetimore në lidhje me këtë rast dhe nëse po, cilat veprime?



- vi. A u janë përgjigjur autoritetet vendore ftesës së Misionit të përfshirë në shënimin e dorëzimit të dokumenteve që i përket këtij rasti? Nëse po, a kanë kërkuar ndihmën e Misionit?
- vii. A ka shkelur apo kontribuar Misioni në shkeljen e të drejtave të ankuesit sipas neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës? Nëse po, në çfarë mënyre?

**KËRKON** nga palët që t'i ofrojnë parashtrësat e tyre në lidhje me meritat e lëndës deri më 16 mars 2010, ndërsa nëse nevojitet më shumë afat, të kërkohet afat shtesë.

Për Panelin,

Guénaël METTRAUX  
Kryesues

Anna BEDNAREK  
Anëtare



Anna AUTIO  
Anëtare